

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Gusht, 2022**

Unitet i shkëlqyer i anëtarësisë së SBASHK-ut

S'ka kërcënim që na lëkund nga kërkesat tona të drejta



Këshilli Qendror Grevist i SBASHK-ut i përgëzon anëtarësinë e SBASHK-ut për unitetin në ditën e parë të grevës e një gjë e tillë u vërejt edhe nga vizitat që i bëmë grevistëve në çerdhen “Yllkat” si dhe në shkollën e mesme të ulët “Gjergj Fishta” në Prishtinë. Vizita u bë së bashku me Këshillin Qendror Grevist të BSPK-së, i kryesuar nga kryetari i këtij Këshilli Rrahman Jasharaj, ku gjatë bashkëbisedimit iu garantuam grevistëve që do të ... (faqe 4)

Disa nga deklaratimet e Kryetarit të SBASHK-ut përmes mediave

Jasharaj: Mos i dërgoni fëmijët në shkollë të enjten, prindërit të kenë konsideratë

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se të enjten në rrethana të zakonshme do të ... (faqe 6)

Intervistë me kryetarin e Këshillit Qendror Grevist të SBASHK-ut Reshit Kushaj

Ndjehem krenar dhe i nderuar me besimin e dhënë



Reshit Kushaj është veprimtar i dalluar ... (faqe 3)

SBASHK –u edhe një herë dëshmon korrektësinë dhe madhësitinë

Apel anëtarëve që të marrin pjesë në komisione dhe administrim të provimit të maturës shtetërore



Pas një takimi që mbajti Këshilli Qendror ... (faqe 5)

Këshilli Grevist takohet me kolegët nëpër komunat e Kosovës

Dita e dytë e grevës edhe më e fuqishme



Në ditën e dytë të grevës ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Qeveria të zgjedhë dialogun e jo shantazhet e kërcënimet



Pasi që përkushtimi i kolegeve e kolegëve tanë kudo në Kosovë nuk u vlerësua as edhe një ditë nga Qeveria sepse nuk iu përgjigj kërkesave të tyre që me dialog e takime të debatohet për problemet e kërkesat legjitime dhe që të ofrohen zgjidhje të pranueshme, e kanë dërguar arsimin e tërë sektorët tjerë në hapin e fundit, e që nuk e deshën, ku nga 25 gushti SBASHK-u u detyrua ti bashkohet grevës së përgjithshme, shpallur nga BSPK.

Greva e sindikalistëve në Kosovë do të vazhdojë deri në realizimin e kërkesave, çdoherë duke i bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të zgjedhë dialogun, e jo “shantazhet e kërcënimet”, ngase nisja e vitit të ri shkollor më 1 shtator do t'i gjejë “nxënësit në shtëpi, e

mësimdhënësit në grevë”, nëse nuk plotësohen kërkesat e tyre. Deklaratat dhe tendencat për t'i frikësuar mësimdhënësit nuk e qetësojnë situatën, nuk japin asnjë rezultat por ndikojnë në përkeqësim të situatës.

Që nga 25 gushti, në grevë janë mësimdhënësit, edukatorët në kopshtet publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës. Kërkesa kyçe e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e nga 100 eurove për punëtorët, derisa të hyjë në fuqi Projektligji për pagat.

Grevën nuk po e bëjnë individët, është vullnet i shprehur nga punëtorët e arsimit që nga çerdhet e deri në universitet.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me kryetarin e Këshillit Qendror Grevist të SBASHK-ut Reshit Kushaj

Ndjem krenar dhe i nderuar me besimin e dhënë



nëpër komuna e në Universitete. Një mbështetje të madhe e kam edhe nga stafi qendror dhe nga fjalët plot entuziazëm të kryetarit të SBASHK-ut. Ky besim më obligon që të jem në krye të detyrës dhe kudo jam prezantoj në mënyrën më të mirë të mundur kërkesat e anëtarësisë.

Arsimimi sot:

A është sfidë e madhe kjo ?

Reshiti:

Nuk është edhe pa sfida. Unë udhëtoj çdo ditë nga Prizreni në Prishtinë. Takohem me kolegët e mi nga Këshilli. Marrim informacione nga terreni lidhur me ecurinë e grevës. Mbajmë komunikim të rregullt me kolegët nga të gjitha komunat dhe Universitetet, me mediat, por shpesh duhet shkuar edhe në debate televizive. Pra, unë bashkë me anëtarët tjerë të Këshillit Grevist dhe me stafin qendror jemi tërë ditën në angazhime, por në angazhime të vazhdueshme janë edhe Këshillat greviste në nivelin komunal, në Universitete e në institucione tjera arsimore.

Arsimimi sot

Cila është rrjedha e grevës ?

Reshiti

Që nga 25 gushti rrjedha e grevës ka qenë në nivel dhe ka dëshmuar unitetin e anëtarësisë në përpjekjet për të realizuar kërkesat legjitime me këtë formë të veprimit sindikal pasi që gjithë angazhimet tjera me dialog e me veprime të përshkallëzuara sindikale nuk kanë dhënë rezultate për shkak të qasjes së gabuar të Qeverisë ndaj dialogut me përfaqësuesit legjitim të të punësuarve në arsim dhe në tërë sektorin publik. Ky unitet do të vazhdojë edhe në të ardhmen, por urojmë që Qeveria, më në fund të angazhohet duke u takuar me Këshillin Qendror Grevist të BSPK-së për gjetjen e zgjidhjes së pranueshme për kërkesat tona legjitime.

Reshit Kushaj është veprimtar i dalluar sindikal. Ai është kryetar i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Prizrenit . Edhe në të kaluarën Reshiti nuk hezitonte që edhe në orët e vona të udhëtonte nga Prizreni në Prishtinë për të përfaqësuar në mënyrën më të denjë në emisione e debate televizive kërkesat e SBASHK-ut. Për grevën e shpallur të 25 gushtit nga BSPK-ja Reshiti iu besua një detyrë e veçantë dhe me përgjegjësi. Ai u zgjodh falë besimit të anëtarësisë kryetar i Këshillit Grevist të SBASHK-ut.

Arsimimi sot

Jeni zgjedhur kryetar i Këshillit Qendror Grevist të SBASHK-ut. Sa e vështirë është kjo detyrë?

Reshiti

Është detyrë me përgjegjësi, por do ta kryej me përkushtim sepse kam përkrahjen e gjithë anëtarëve të këtij Këshilli dhe të kryetarëve e këshillave greviste

S'ka kërcënim që na lëkund nga kërkesat tona të drejta

Këshilli Qendror Grevist i SBASHK-ut i përgëzon anëtarësinë e SBASHK-ut për unitetin në ditën e parë të grevës e një gjë e tillë u vërejt edhe nga vizitat që i bëmë grevistëve në çerdhen “Yllkat” si dhe në shkollën e mesme të ulët “Gjergj Fishta” në Prishtinë.



Vizita u bë së bashku me Këshillin Qendror Grevist të BSPK-së, i kryesuar nga kryetari i këtij Këshilli Rrahman Jasharaj, ku gjatë bashkëbisedimit iu garantuam grevistëve që do të qëndrojmë unik e të pa luhatur në realizimin e kërkesave të drejta pavarësisht presioneve, shantazheve e kërcënimeve që vijnë nga Qeveria apo nga ndonjë person tjetër.



Kërkojmë mirëkuptim prej prindërve dhe me mirësi i lusim që të gjitha kërkesat e tyre të i orientojnë kah Qeveria, sepse anëtarësia jonë sindikale ka kontratë me institucionet e shtetit të cilave iu përgjigjet.

Greva është mjet demokratik i veprimit sindikal i lejuar me ligj dhe kushtetutë e çdo kërcënim nga kushdo që vjen dhe për çfarëdo qëllimi që ka për synim ndërprerjen e grevës është i dëmshëm. Sipas

ligjit mbi organizimin e grevave ne me kujdes do të monitorojmë kërcënimet e tilla dhe ndaj atyre që i përdorin këto lloj kërcënimesh do të ngrisim kallëzim penal, dhe nëse grevistët pengohen gjatë grevës në vendet e punës, ne do të shqyrtojmë me shumë seriozitet kalimin në formën tjetër të grevës duke mos u paraqitur në vendet e punës, ashtu siç është paraparë në ligjin mbi grevat.



Apelojmë te kryeministri z.Kurti dhe të ministrja e Arsimit znj.Nagavci nëse vërtet dëshirojnë të fillon viti shkollor, t'i realizojnë kërkesat e punëtorëve e të ftojnë sindikatat për marrëveshje dhe duhet ti trajtojnë dhe konsiderojnë partnerë social dhe jo kundërshtar.



SBASHK –u edhe një herë dëshmon korrektësinë dhe madhështinë

Apel anëtarëve që të marrin pjesë në komisione dhe administrim të provimit të maturës shtetërore

Pas një takimi që mbajti Këshilli Qendror Grevist i SBASHK-ut në të cilin takim ishte prezent edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në cilësinë e kryetarit të Këshillit Qendror Grevist të BSPK-së, Ali Gashi kryetar i SPAK, në cilësinë e nënkryetarit të Këshillit Qendror Grevist të BSPK-së dhe Vjollca Shala, nënkryetare e SBASHK-ut me kryetarin e Kolegjiumit të drejtorëve arsimor të Asociacionit të komunave të Kosovës, Samir Shahini, i cili në emër të kolegëve, drejtorë të DKA-ve paraqiti kërkesën për një mirëkuptim që ditën e shtunë me datën 27.08.2022 ashtu siç është e paraparë mbajtja e provimit të maturës shtetërore, që SBASHK-u të iu sugjeroj mësimdhënësve që të marrin pjesë në obligimet e tyre të caktuara nga MASHTI.

Këshilli Qendror Grevist i SBASHK-ut bashkërisht edhe me kryetarin e SBASHK-ut falënderuan z.Shahini për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke pas parasysh se ky bashkëpunim duhet të vazhdoj edhe në të ardhmen si dhe duke pas për bazë edhe interesin

e nxënësve maturant dhe pas konsultimeve edhe me kolegët sindikalist nga tereni, vendosi që të iu sugjeron të gjithë anëtarëve të SBASHK-ut të cilët janë të caktuar për pjesëmarrje në monitorim të procesit të provimit të maturës shtetërore që të marrin pjesë duke e njoftuar opinionin e gjerë dhe anëtarësinë se ky do të jetë veprimi i fundit që do të bëjmë aktivitete gjatë kohës sa zgjatë greva.



Këshilli Grevist takohet me kolegët nëpër komunat e Kosovës

Dita e dytë e grevës edhe më e fuqishme



Në ditën e dytë të grevës Këshilli Grevist i SBASHK-ut ka bërë vizita në komunën e Lipjanit dhe Shtimes, ku vizitua shkollën “Ismail Luma” në Lipjan dhe çerdhen e kësaj komune dhe poashtu në komunën e Shtimes u vizitua shkolla “Emin Duraku”. Gjatë takimit me sindikalistët u bisedua për ecurinë e grevës si dhe për kërcënimet dhe presionet që kanë filluar të zhvillohen karshi sindikalistëve grevistë.



Përkundër kësaj grevistët ishin të vendosur të vazhdohet me grevën pa marr parasysh presioneve kush i bënë dhe nga vijnë deri në realizimin e kërkesave tona që janë të njohura për publikun.



Përfaqësuesit e nivelit qendror të SBASHK-ut u thanë sindikalistëve se ata do të qëndrojnë të vendosur për të realizuar kërkesat e tyre, ndërsa për presionet u informuan se zyra ligjore pranë BSPK-së do të analizoj këto presione e kërcënime dhe do të përgatis kallëzim penal karshi atyre që kanë filluar të i bëjnë këto presione ose edhe ata që do ti bëjnë.

Greva vazhdon në gjithë Kosovën derisa Qeveria të reflekton, të bën zgjidhjen e kërkesave tona.



Disa nga deklaratimet e Kryetarit të SBASHK-ut përmes mediave

Jasharaj: Mos i dërgoni fëmijët në shkollë të enjten, prindërit të kenë konsideratë



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka thënë se të enjten në rrethana të zakonshme do të kishte fillim të vitit shkollor, por sipas tij, pasi po mungon dialogu

me Qeverinë, prandaj punëtorët e arsimit do të jenë në grevë.

Ai u ka kërkuar falje prindërve, por ka shtuar se nuk ka zgjidhje tjetër. Jasharaj ka thënë se për hir të sigurisë së nxënësve, ata nuk duhet të dërgohen në shkolla.

“Të gjithë duhet të ndikojnë që të kemi dialog në mënyrë që greva të zgjasë më pak. Tendencia për t'i frikësuar mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të sektorit publik nuk i ndihmojnë situatës. Edhe Murati dhe Nagavci do duhej të jepnin ndonjë fjalë të mirë sepse me dialog zgjidhen të gjitha çështjet. Kemi harxhuar të

gjitha mundësitë me shpresën që të gjitha do të zgjidhen”, ka thënë ai.



Ai thotë se kanë pritur dialog nga Qeveria, porse sipas tij, nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.

Jasharaj ka thënë se Qeveria ka ende kohë që të bisedojë me sindikatat. Ai ka thënë se kanë pasur takim edhe me prindërit dhe i kanë lutur që të kenë konsideratë.

“Nëse kemi informacione që dikush në shkolla po tenton të ushtroj presion, do ta telefonojmë Policinë e

Kosovës. Për ata që do të ushtrojnë presion, do të përgatisim kallëzime penale. Le të ofrojnë zgjedhje. Nxënësit nuk kanë çka të vijnë në shkollë. Grevën nuk po e bëjnë individët por është vullnet i shprehur nga punëtorët e arsimit”, ka thënë ai.

Ai ka thënë se nuk mund të ulen pagat e mësimmësuesve për shkak të grevave.

Jasharaj ka thënë se nuk ka pasur tensione në takimin me prindërit dhe se greva do të vazhdojë derisa Qeveria të mos ofrojë zgjedhje të pranueshme.



Angazhime të shumta të sindikalistëve për dialog , por Qeveria vazhdoi me injorimin

BSPK-ja shpalli grevë të përgjithshme nga 25 gushti



Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka shpallur të enjten e 17 gushtit grevë të përgjithshme për shkak të mosrealizimit të kërkesave të tyre nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, ka thënë se obligohen që të gjithë punëtorët të hyjnë në grevë. Ai ka thënë se greva do të nisë nga 25 gushti dhe do të zgjasë derisa të përmbushen kërkesat e tyre.

“Kërkojmë 100 euro shtesë deri sa të miratohet Ligji për paga. Më 10 gusht 2022 BSPK-ja ka mbajtur mbledhjen e jashtëzakonshme me qëllim të sigurimit të situatës. BSPK-ja përsëri ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore drejt realizimit të kërkesave, por nuk ia doli të ulet me Qeverinë dhe të gjejnë një rrugë të duhur. Prandaj sot dua t’u informojë se ligji është ai që na obligon të hyjmë në grevë, dhe për këtë shkak sot po e shpallim grevën e përgjithshme për shkak të mosrealizimit të kërkesave”, ka thënë Hykolli në konferencën për media.

Këshilli Grevist i SBASHK-ut i përkushtuar në detyrat konkrete Udhëzues i qartë për rrjedhën e grevës



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Rr. Agim Ramadani p.n - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë, Tel/Fax: +383(0)38/226-940,
www.sbashk-rks.org E: sbashk2004@yahoo.com, info@sbashk-rks.org

Bazuar në njoftimin e këshillit grevist të BSPK-së të datës 18.08.2022 dhe vendimit nr. 1826/1 të datës 22.08.2022, këshilli grevist i SBASHK-ut nxjerr këtë:

U D H Ë Z U E S

1. Orari i grevës fillon nga ora 09:00 deri në ora 12:00 për të dy ndërrimet bashkërisht, përveç në ndonjë rast specifik i lihet në mundësi këshillit grevist të shoqatës sindikale të vendos për orarin. Me përfundimin e orarit të grevës përfundon edhe obligimi i paraqitjes në vendin e punës.
2. Të punësuarit të cilët gjenden në pushime vjetore, pushime mjekësore dhe pushime të tjera nuk kanë obligim të paraqiten në grevë.
3. Në bazë të ligjit për grevën bien poshtë të gjitha obligimet e të punësuarit të cilat burojnë nga kontrata e punës.
4. Lejohet të mbahen komisione të konkurseve të ndryshme të cilat kanë qenë në proces me herët.
5. Të caktohet nga një person në secilën shoqatë sindikale, i cili mund të kryej ndonjë punë të domosdoshme logjistike sipas nevojës.
6. Pjesëmarrësit në grevë duhet të nënshkruhen çdo ditë në listën e pjesëmarrjes në grevë.
7. Këshilli grevist i shoqatës sindikale duhet të raportoj çdo ditë tek këshilli grevist i SKAP-it përkatës dhe të SUSHK-ut, e pastaj këshilli grevist i SKAP-it dhe SUSHK-ut raporton tek këshilli grevist qendror i SBASHK-ut.

Prishtinë: 23.08.2022

Këshilli grevist i SBASHK-ut

1. Reshit Kushaj
2. Luljeta Boshnjaku
3. Hanife Salihu



GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 79 / 24 GUSHT 2010

LIGJI Nr. 03/L-2000

PËR GREVA

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

miraton:

LIGJ PËR GREVA

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim garantimin e lirive dhe të drejtave, lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në Kosovë në grevë sipas standardeve ndërkombëtare.

Neni 12 Këshilli Grevist

1. Këshilli Grevist udhëheq me grevën dhe përfaqëson interesat e grevistëve.

2. Këshilli Grevist dhe përfaqësuesit e organeve të punëdhënësit që janë paralajmëruar për grevën, prej datës së paralajmërimit të grevës dhe gjatë grevës, kanë për detyrë që të insistojnë t'i zgjidhin kërkesat e tyre me marrëveshje.

3. Këshilli Grevist dhe të punësuarit të cilët marrin pjesë në grevë kanë për detyrë të organizojnë dhe të udhëheqin grevën në mënyrë që të mos rrezikohet siguria, shëndeti i njerëzve, pasuria, dhe të vazhdojnë punën pas përfundimit të grevës.

Neni 13 Mbrotja e të drejtave të punësuarve gjatë grevës

1. Për organizuesit e grevës, pjesëmarrësve grevistë dhe ndaj të punësuarve të tjerë, të cilët mbështesin grevën, nuk mund të merren masa disiplinore apo materiale dhe nuk mund t'ju ndërpritet marrëdhënia e punës.

2. Gjatë grevës së organizuar sipas kushteve të përcaktuara me këtë Ligj, punëdhënësit nuk mund të punësojnë punëtorë të rinj të cilët do të zëvendësojnë pjesëmarrësit në grevë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Argumente që dëshmojnë se kërkesat e anëtarësisë janë shumë të arsyeshme Rritja e madhe e çmimeve ka varfëruar shportën familjare

Norma e konsumit mujor në njësi matëse.

Produktet kryesore ushqimore dhe shpenzimet e domosdoshme të familjes pa gjera ligjore, vesabotshjet, llogara e shërbime shëndetësore

Nr	Produktet	Sasia mujore	2019	2020	2021	Qershor 2022	2019	2020	2021	Qershor 2022
1	Bakë 0.5 kg/cope	30.0	0.35	0.35	0.42	0.46	10.50	10.5	12.6	13.5
2	Makaronat/kg	1.0	0.65	0.78	0.89	1.03	0.65	0.78	0.89	1.03
3	Oriz/kg	1.0	1.33	1.43	1.44	1.46	1.33	1.43	1.44	1.46
4	Fasule/kg	1.0	2.39	2.54	2.64	2.82	2.39	2.54	2.64	2.82
5	Patate/kg	6.0	0.58	0.62	0.63	0.82	3.48	3.72	3.78	4.92
6	Perime të freskëta/kg	12.0	1.06	1.22	1.34	1.53	12.72	14.64	16.08	18.36
7	Frute të freskëta/kg	6.0	1.34	1.44	1.45	1.68	8.04	8.64	8.7	10.08
8	Marrullat/kg	1.5	1.43	1.52	1.65	1.87	2.15	2.28	2.475	2.805
9	Sheqer/kg	1.5	0.68	0.7	0.87	1.03	1.02	1.05	1.305	1.545
10	Valuta	2.0	1.02	1.15	1.69	2.8	2.04	2.3	3.38	5.6
11	Mish njepruajtë/kg	3.0	5.89	7.58	7.98	8.94	17.62	22.74	23.94	26.82
12	Qumësht e kos l	9.0	0.71	0.87	0.92	1.09	6.39	7.83	8.28	9.81
13	Djathë/kg	1.0	3.94	4.25	4.75	6.1	3.94	4.25	4.75	6.1
14	Veçit/cope	30.0	0.08	0.10	0.11	0.13	2.37	3.01	3.3	4.8
15	Energji elektrike kWh	570.0	0.042	0.042	0.042	0.0673	2.37	23.94	23.94	38.478
16	Ujë njepruajtë/kg	12.0	0.82	0.86	0.86	0.88	9.84	10.32	10.32	10.56
17	Drejtore liter	45.0	1.1	0.78	1.05	1.84	49.5	35.1	47.25	83.7
18	Ngrahje dritë 12 m3 vit	1.0	35	35	39	55	35	35	39	55
Vlera ushqimore (114) në muaj/ anëtar							74.64	85.71	93.56	100.05
Vlera për muaj ushqyese për 4 anëtarë dhe shpenzimet e shërbimeve							398.3	447.2	494.8	626.3

Kërkesat e SBASHK-ut dhe federatave të tjera në kuadër të BSPK-së janë bërë publike tani e sa kohë dhe janë shumë e shumë argumente që dëshmojnë se ato janë legjitime dhe të arsyeshme. Kjo vlen edhe për kërkesën që deri në fillimin e implementimit të Ligjit të pagave Qeveria të bëjë një shtesë në pagë në vlerën prej 100 euro për të gjithë të punësuarit në sektorin publik. Më shumë se qindra fjalë dëshmon ky pasqyrim.

<https://www.facebook.com/100006437309901/videos/375773678009647/>

Tabela dhe pasqyrimi grafik i rritjes së çmimeve nga viti 2018 e deri në qershorin e 2022 tregon më së miri sa është e domosdoshme rritja e pagës për të punësuarit në Kosovë.



Ministrja Nagavci vazhdon shëtitjet nëpër komuna Podujeva ishte adresa e saj e radhës



Në takimin e Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, me disa mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave të arsimit para universitar të komunës së Podujevës, ku ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës, Shpejtim Bulliqi e drejtori komunal i Arsimit, Avni Fetahu. Në këtë takim i pranishëm ishte edhe kryetari i Sindikatës së Arsimit fillor e të mesëm për këtë komunë Fadil Halimi, i cili ka kërkuar nga ministrja Nagavci, që t'i

marr në konsideratë kërkesat e mësimdhënësve dhe të ndihmojë në zgjidhjen e kërkesave legjitime në mënyrë që të mos shkohet në veprimin e fundit sindikal siç është greva e përgjithshme.



Në këtë takim kryetari Halimi e ka njoftuar Ministren se derisa ne po diskutojmë lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, pritet të shpallet greva e përgjithshme, nga BSPK-ja, në të cilën merr pjesë

edhe SBASHK-u. Ky lajm sikur e zuri në befasi ministren.

Më tej kryetari Halimi theksoi se në këtë “betejë” jemi humbës të gjithë si nxënësit ashtu edhe në mësimdhënësit, sepse orët e humbura në asnjë rast nuk mund të zëvendësohen. Ai ka apeluar që Ministria të jetë zëri i punëtorëve arsimor në prezantimin e shqetësimeve dhe pakënaqësive në kabinetin qeveritar dhe të kërkojë një shtesë në pagë prej 100 eurove deri

në nxjerrjen e Ligjit të pagave, ndonëse kjo shtesë është e pamjaftueshme në këtë kohë krize.

“Po ashtu nga ministria Nagavci kam kërkuar edhe implementimin e Kontratës Kolektive dhe punonjësit arsimorë të mos kenë nevojë më t’u drejtohen gjykatave e përmbaruesve. Deri më tash të gjitha paditë e bëra nëpër gjykata janë realizuar në favor të mësimdhënësve”, është shprehur kryetari Halimi.

Reagim ndaj një deklarimi ironik të Ministres së Arsimit

Jasharaj – Nagavci: Nëse të duken pak 100 euro, na i shto nga 200 apo 300

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës të Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, bëri humor pa kripë kur vëri pikëpyetjen në një konferencë për media, se përse sindikalistët kanë kërkuar 100 euro shtesë në paga deri në miratimin e Ligjit për Paga, dhe jo 300 apo 80.

Jasharaj përmes një reagimi të shtunën, ka thënë se kërkesa për 100 euro është bërë sepse u është dukur më lehtë e realizueshme.

Sipas tij, nëse kanë kërkuar pak para, atëherë le të bëjë ajo kërkesë për një shtesë më të madhe.

“Kur jemi te kjo kërkesa modeste drejtuar Qeverisë për 100 euro shtesë në paga, Ministria Nagavci bëri një humor pa fije kripe duke na kritikuar se pse paskemi kërkuar pikërisht 100 euro e jo , bie fjala , 300 euro. Ministre ne e kemi ditur se kjo kërkesë është minimale dhe e pamjaftueshme karshi gjithë këtyre ngritjeve të çmimeve, por e kemi bërë sepse mund të realizohej po të donte Qeveria. Nëse ju mendoni se kemi kërkuar pak dhe nuk e keni me tallje, atëherë si Ministre e tërë arsimit që je, kërko dhe realizo në Qeveri kërkesën tënde për 200 a 300 euro shtesë dhe ne do të jemi më të lumturit dhe do të ndjehemi krenar me ty”, ka shkruar Jasharaj.

Ai ka kritikuar Qeverinë e Kosovës duke thënë se ka qasje të gabueshme ndaj sindikatave dhe dialogut, dhe se po krijon mjegull për Ligjin e pagave dhe ligjet tjera.

“Humori pa kripë e ka sjellë situatën deri të greva e përgjithshme dhe nëse Ministria Nagavci dhe Qeveria e kanë vërtetë hallin të nxënësit dhe orët e ditët e humbura nga greva, le të nisnin me dialogun dhe plotësimin e kërkesave të sindikatave, që janë në kuadër të BSPK-së”, ka shkruar Jasharaj.



SBASHK-u as në të kaluarën e as sot nuk është vetëm

Mbështetjet nga ETUCE dhe sindikatat tjera

SBASHK-u , sikur në të kaluarën, edhe tani në grevën e përgjithshme ka pasur dhe ka përkrahje të fuqishme nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës

(ETUCE) në emër të 11 milionë anëtarëve, por dhe nga sindikatat simotra veç e veç.

Përmes këtij linku mund të lidheni direkt në videon mbështetëse të ETUCE-së:

<https://www.facebook.com/EuropeanTradeUnionCommitteeForEducation/videos/7985618854845363>



Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë- FSASH

Drejtor Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës- SBASHK

Tiranë, më 25.08.2022

I nderuar Z. Jashari,

Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, FSASH ka ndjekur me vëmendje veprimet e SBASHK që nga fillimi i këtij viti për krijimin e pagave e përmirësimit të kushteve të punës për mësuesit dhe shkollorët.

Vlerësojmë përpjekjet që keni bërë për të arritur një zgjidhje mirëkuptimi me qeverinë, ndërkohë që shprehim keqardhjen për indiferentizimin e treguar nga Qeveria e Kosovës. Ky qëndrim dëmtim mësuesit si figura qëndrore të shkollës dhe arsimin në përgjithësi në prag të fillimit të vitit të ri shkollor.

Urojmë arritjen e një zgjidhje të pamëshere para fillimit të vitit shkollor.

Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë është në mbështetje të plotë të kërkesave të SBASHK-ut për përmirësimin e kushteve ekonomike të mësuesve dhe krijimin e cilësive të arsimit në Kosovë.

Me respekt,

Isa Reka

Kryetar



Shkupje, 25.08.2022

To
The Union of Education, Science and
Culture of Kosovo - SBASHK

Letter of support

Dear colleagues,

On behalf of SONK and on my own behalf, with this letter, I want to express our solidarity and support for your announcement of a General Strike.

The main tool for realizing workers' rights is the social dialogue, but unfortunately, after almost a year of efforts for negotiations, and even two organized protests, your Government did not agree to dialogue, so the next step is the General Strike.

We stand in solidarity with the SBASHK and your requests for the adoption of the law on salaries as soon as possible and start its implementation, implementation of the law on health insurance as well as the amendment of the law on state-funded pension schemes.

We appeal to your Government to start negotiations and meet the education workers, to fulfill your demands, because it is one more step in restoring the dignity of the educational profession.

Dear trade union friends,

We fully support your decision and wish you to persevere in realizing your legitimate and reasoned demands.

With mutual support, we will create a strong trade union movement in our region, and thus a strong protection of the trade union and labor rights of our membership.

Once again, on behalf of SONK and on my behalf, I wish you a successful strike and positive results.

SONK is with you!

In solidarity,

President,

Jakim Nedelkov



Më poshtë janë disa nga letrat mbështetëse nga disa sindikata simotra:



Subject: Support Letter

24.08.2022

Dear Rrahman Jashari,

We are aware of the struggle given by your union in order to improve the quality of education and the social and financial rights of teachers. We fully support your decision to go on strike in order to make the government accept your demands and we want you to know that we stand with you in your struggle.

Sincerely,

ABVALÇIN

President



Shqiptarë Sindikale
QKUK

REAGIM

Duke pasur parasysh parimet bazë të sindikalizmit – Solidaritetin, me anëtarët e shoqatës sindikale të QKUK, i përkrahim kërkesat e SBASHK-ut dhe administratës publike.

Kërkesat tona për mirënjohje të punës dhe shërbimeve të shërbimit, në vazhdimësi janë ngritur por kapakunsa ka vu kjo qeveri e cila me paturpësi më të madhe deklarohet me orientime – Socialdemokratike ndërsa veprimet e ndërmarrura e rangonin në qeveri autokratike dhe ekstremist dhe tërësi, këtë e dëshmon veprimi ndërkohë i ndërmarrur dhe, kështu punëtorët, në vend që të ulen në dialog social për të zgjidhur hallet dhe problemet e shpirtit të klases punëtorë, halle këto të cilat janë mitur shumë nga inflacioni gallopan.

Sa i përket deklaratave të dëshmitë të PS-SHK e cila është prononcuar kundër solidarizimit me greven e kolegëve të SBASHK-ut dhe administratës publike, kjo udhëheqje e kundërshtueshme, e dahu nga procesi manipulues zgjedhës, e ndihmon rritjen e punës dhe segmentit të caktuar të partisë më të madhe opozitare – janë të borbosha politike, andaj nuk mund ta ngjasin këto dhe të mbrojnë interesat e klases punëtorë të RKS e besa as të punëtorëve shërbëtorë.

Ne anëtarë të SHS të QKUK e kemi kuptuar që ligjin mbi pagat, i prolonguar nga kjo qeveri që një vit, edhe kështu si është detyruar të bëjë për të mos u miratuar!

Edhe nëse miratohet, hyrja në fuqi pas tërësuarit e bën të pa vlerë sepse ai nuk i zgjidh problemet sociale.

Tani nevojitet në publikim dhe koeficienti pa vlerë të caktuar dhe pa e bërë rangimin e mirëfiks sipas meritave dhe gradave.

Ju politikëerë të këtij vendi ekeni detyrues në vazhdimësi sektorin publik të shërbimeve me veprimet tuaja politike dhe aktualisht është në buzë të shthurjes dhe shkatërrimit dhe mbi bazën e kesaj SHS e QKUK ja tërësi që vërejtjen kesaj qeverisjeje se ne nuk pajtohemi me këtë gjendje në të cilën është sjellur shërbëtorët dhe ditëve në vijim do të marrim vendime për marifetimin e kesaj paknaqësie me këtë gjendje, me veprimet sindikale atyja dhe nga kërkuesit bariket janë.

Rritja e mirënjohjes së punëtorëve shërbëtorë në sektorin publik.

Investimet në shërbëtorët publikë.

Rritja e cilësive të shërbimit e cila varet nga këto investime.

Pagat sipas meritave dhe gradave të punës-ndaj dhe rangimi sipas niveleve primar, sekondar, terciar dhe sipas gradave. Këto do të jenë disa nga kërkesat bazë për ta shpëtuar sistemin shërbëtorë publik dhe ngjiten e mirënjohjes së punëtorëve të këtij sistemi.

Me respekt,

Dr. Xhemal Selmani

Prishtinë, dt: 26.08.22

